



Rrugëtimi juaj në qendrën e vaksinimit



MIRË SE ERDHE!

Sot të bëhet vakcina kundër koronavirusit. Si bëhet kjo?

► Hapi 1: pritja

Ti shkon tek **pritja**. Mbaj gati këta dokumentë:

- Kartën tënde të identitetit ose kartën eID (elektronike)
- Letrën mbi vaksinimin
- Kartën tënde të vaksinimit: nëse të është bërë vakcina e parë kundër koronavirusit

► Hapi 2: biseda

Plotëso së pari pyetjet në pjesën e prapme. Pastaj flet me një infermier/-e mbi shëndetin tënd.

A je mjaftueshëm i shëndetshëm? A të bëhet sot vakcina? Atë e vendos infermieri / -rja.

- Nëse sot **të bëhet** vakcina, atëherë më pas të jepet një kartë. Ruaje mirë atë!
- Nëse sot **nuk të bëhet** vakcina, atëherë infermieri/-rja të sqaron se çfarë duhet të bësh.

► Step 3: Vaccine

Ty të bëhet vakcina jote.

► Hapi 4: prit 15 minuta

Shko tek **ambjenti i qetësimit**. Prit këtu 15 minuta. Nëse ke reaktion alergjik nga vakcina, atëherë ne mund të të ndihmojmë menjëherë.

Pas 15 minutash lejohet të shkosh në shtëpi.

► Bëj kujdes!

- Ka disa lloje vaksinash. Tek disa vakcina duhet të të bëhet **2** herë një injeksion. Kjo është e rëndësishme. Pas herës së dytë je i mbrojtur më mirë.
- Disa ditë pas vaksinës mund të të shfaqen shqetësime/ankesa. Ke dhimbje, skuqje të lëkurës, enjtje në krah? Ke gjëndërra të enjtura në qafë, sqetulla ...? Ke dhimbje koke, dhimbje muskujsh, temperaturë, dhimbje të kyçeve / nyjeve të tua (gjunjë, gishta ...)? Je i lodhur apo ke pështjellim (të vjen për të vjellë)?
- Nëse në shtëpinë tënde ke **reaktion alergjik**, apo nëse ke skuqje/ reaktion në të gjithë trupin, atëherë kontakto mjekun tënd të familjes.

Nëse shqetësimet vazhdojnë apo të shfaqen shqetësimet të tjerë, atëherë kontakto **mjekun tënd të familjes**.

FALEMINDERIT QË DËSHIRON TË VAKSINOHESH!

Vazhdo t'i ndjekësh rregullat kundër koronavirusit

Ti mund t'ia transmetosh virusin të tjerëve edhe pas kësaj.



Vër/mbaj një maskë për gojë aty ku duhet.



Dezinfekto duart e tua.



Mbaj 1,5 metra distancë nga të tjerët.

Pyetje mbi shëndetin tënd

Lexoji mirë pyetjet! Vendos një x tek 'po' ose 'jo' !

Përgjigju ndershmërisht! Kjo është për shëndetin tënd.

Nuk e kupton ndonjë pyetje? Atëherë infermieri/-rja do të ndihmojë pas pak.

Pyetje	Po ose Jo		Sqarim
<p>1. A e ke marrë tashmë një vaksinë për koronavirus?</p> <ul style="list-style-type: none"> Po? Përgjigju pyetjes së mëposhtme!: <p>Çfarë marke dhe para sa kohësh? Shiko kartën tënde të vaksinimit! .</p> <p>.....</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Ne kontrollojmë që ti t'a marrësh vaksinën me korrektësi.</p>
<p>2. A ndihesh sot i/e sëmurë? (temperaturë, dhimbje fyti, kollitje, vështirësi në frymëmarrje, nuk nuhat mirë, ...)</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Sot nuk të bëhet vaksinë. Merr një takim tjetër vetëm kur të jesh shëruar.</p>
<p>3. A ke pasur ankesa në 14 ditët e fundit (simptoma) nga koronavirusi dhe sipas një testi, a ke pasur koronavirus?</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Sot nuk të bëhet vaksinë. Lejohet të marrësh një vaksinë nëse ka 14 ditë që ti nuk ke pasur ankesa nga koronavirusi.</p>
<p>4. A ke bërë një test për koronavirus në 14 ditët e fundit dhe sipas atij testi, a ke pasur koronavirus pa ankesa (simptoma)?</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Sot nuk të bëhet vaksinë. Lejohet të marrësh një vaksinë 14 ditë pas testit tënd.</p>
<p>5. A duhet të jesh tani në karantinë? Për shembull: sepse ti ke pasur kontakt me dikë me koronavirus.</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Lejohet të marrësh një vaksinë vetëm 14 ditë pas kontaktit tënd me dikë me koronavirus.</p>
<p>6. A ke bërë një vaksinë në 14 ditët e fundit?</p> <ul style="list-style-type: none"> Po? Përgjigju pyetjes së mëposhtme!: <p>Para sa kohësh?</p> <p>.....</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Mjeku të bën disa pyetje shtesë.</p>
<p>7. A të shkakton alergji PEG (polyethyleenglycol) ose polysorbaat?</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Mos u shqetëso nëse nuk e di se çfarë është kjo!</p> <p>Po? Mjeku të bën disa pyetje shtesë.</p>
	<p>Nuk e di se çfarë është kjo</p> <input type="checkbox"/>		
<p>8. A ke pasur ndonjëherë reaksion të fortë kundër ndonjë ilaçi apo vaksine?</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Mjeku të bën disa pyetje shtesë.</p>
<p>9. A ke pasur ndonjëherë një anafilaksi (= reaksion alergjik serioz me rrezikim të jetës)?</p>	<p>Po</p> <input type="checkbox"/>	<p>Jo</p> <input type="checkbox"/>	<p>Po? Mjeku të bën disa pyetje shtesë.</p>

Pyetje	Po ose Jo		Sqarim
10. A ke pasur ndonjëherë një quincke oedeem edemë (= ënjtje në fyt, gjuhë)?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Po? Mjeku të bën disa pyetje shtesë.
11. A ke mastocitozë sistemike ose angioedemë të trashëguar?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Mos u shqetëso nëse nuk e di se çfarë është kjo! Po? Mjeku të bën disa pyetje shtesë.
	Nuk e di se çfarë është kjo <input type="checkbox"/>		
12. Gratë: A je shtatëzënë (me barrë)?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Po? Ne kujdesemi që ti të marrësh tipin e saktë të vaksinës. Përveç rastit nëse ti e ke marrë tashmë dozën e parë të vaksinës kundër koronavirusit. Në atë rast të bëhet e njëjta vaksinë.
13. A ke astma? Dhe a ke shumë ankesa nga kjo megjithëse merr ilaçe për këtë?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Po? Ka mundësi të të shkaktohet një reaksion alergjik, por mundësia është e vogël. Rri 30 minuta në sallën e qetësimit pasi të marrësh vaksinën! Kështu që ne mund të të ndihmojmë nëse të shkaktohet reaksion nga vaksina.
14. A ke epilepsi, apo ke pasur ndonjëherë?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Po? Mos u shqetëso! Ti lejohet të vaksinohesh. Ka mundësi që të shkaktohet temperaturë nga vaksina. Për këtë ti mund të marrësh paracetamol në rast se nga temperatura të shkaktohen kriza.
15. A të janë hequr gjëndërrat në sqetullin tënd? Për shembull: sepse ti ke pasur kancer të gjirit. • Po? Në cilën anë?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Po? Ne kujdesemi që ti të marrësh vaksinën tënde në mënyrë të saktë.
	Majtas <input type="checkbox"/>	Djathtas <input type="checkbox"/>	
	Të dyja anët <input type="checkbox"/>		
16. A merr ti ndonjë ilaç për hollimin e gjakut? Për shembull: Asaflow, Ascal, Aspegic, Aspirine, Cardioaspirine, Clopidogrel, Clexane, Fraxiparine, Fragmin, Heparine, Plavix, Sintrom, Marcoumar, Marevan, Pradaxa, Eliquis, Lixiana, Xarelto, ...	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Po? Ne e shtypim më gjatë vendin e gjilpërës.
17. A ke pyetje të tjera?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	